

VENDIM
Nr. 459, datë 30.7.2021

PËR PËRCAKTIMIN E RAJONEVE TË ZHVILLIMIT DHE KUFIJVE TË TYRE

(Ndryshuar me VKM nr. 356, datë 20.5.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rajoneve të zhvillimit dhe kufijve të tyre, si më poshtë vijon:
 - a) Rajoni i zhvillimit 1, i cili përfshin territoret që shtrihen në njësitë e vetëqeverisjes vendore:
 - i. të nivelit të parë: Shkodër, Malësi e Madhe, Fushë-Arrëz, Pukë, Vau i Dejës, Kukës, Has, Tropojë, Lezhë, Mirditë, Kurbin;
 - ii. të nivelit të dytë: Shkodër, Lezhë, Kukës;
sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Rajoni i zhvillimit 2, i cili përfshin territoret që shtrihen në njësitë e vetëqeverisjes vendore:
 - i. të nivelit të parë: Tiranë, Kamzë, Vorë, Kavajë, Rrogozhinë, Durrës, Krujë, Shijak, Dibër, Mat, Klos, Bulqizë, *Elbasan, Librazhd, Përrenjas, Gramsh, Cërrik, Peqin e Belsh;*
Territoret që shtrihen në njësitë e vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë Tiranë dhe Kamzë identifikohen si zonë metropolitane me karakter të veçantë.
 - ii. të nivelit të dytë: Tiranë, Durrës, Dibër dhe *Elbasan;*
sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - c) Rajoni i zhvillimit 3, i cili përfshin territoret që shtrihen në njësitë e vetëqeverisjes vendore:
 - i. të nivelit të parë: *Gjirokastrë, Memaliaj, Tepelenë, Përmet, Këlcyrë, Libohovë, Dropull,* Korçë, Pogradec, Pustec, Maliq, Devoll, Kolonjë, Berat, Dimal, Kuçovë, Poliçan, Skrapar;
 - ii. të nivelit të dytë: *Gjirokastrë,* Korçë, Berat;
sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - ç) Rajoni i zhvillimit 4, i cili përfshin territoret që shtrihen në njësitë e vetëqeverisjes vendore:
 - i. të nivelit të parë: Fier, Divjakë, Lushnjë, Roskovec, Patos, Mallakastër, Vlorë, Selenicë, Himarë, Delvinë, Sarandë, Finiq, Konispol;
 - ii. të nivelit të dytë: Vlorë, Fier;
sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Fondi Shqiptar i Zhvillimit, ministritë e linjës, njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe subjektet e tjera përgjegjëse në zhvillimin rajonal, të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 102/2020, “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

ANEKS 1
HARTA E RAJONEVE TË ZHVILLIMIT
(Zëvendësuar me VKM nr. 356, datë 20.5.2026)

